

MARREVESHJE

Ne Tirane, sot me date 17/01/2015, ne seline e shoqerise "KLAR" shpk, u mblodhen palet e meposhtme;

PALET:

1- SHOQERIA « KLAR» SHPK, e pajisur me NIPT K81309049N, me seli ne Rr "Durrës-itish Uzina Tirana", me ortak te vetem Shkelqim Beshiri dhe perfaqesuar ne kete akt marrveshje nga Administratori Gentjan Sali, i biri i Bujarit, i dtl 15.10.1979, lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane, i pajisur me karte identiteti Nr 024453241, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

2- SHOQERIA "LADJUS" shpk, e pajisur me NIPT L12227010D, me seli ne Rr "Loçka", prane Komunes Kashar, Yrshek, me ortak te vetem Shkelqim Beshiri dhe perfaqesuar ne kete akt marrveshje nga Administratori Gentjan Sali, i biri i Bujarit, i dtl 15.10.1979, lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane, i pajisur me karte identiteti Nr 024453241, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BAZA LIGJORE: Neni 215 e ne vijim e Ligjit Nr 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare", I ndryshuar; Ligji Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" I ndryshuar; Vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise "Klar" shpk , date 11.12.2014 "Per inicim procedure bashkim me perthithje"; Vendimin e Asamblese se Ortakut te vetem te shoqerise "Ladjus" shpk date 11.12.2014 "Per inicim procedure bashkim me perthithje";

Te cilet rane dakord ne nenshkrimin e kesaj marreveshjeje, si ne vijim:

1- Shoqeria "Ladjus" shpk, e pajisur me NIPT L12227010D dhe seli ne ne Rr "Loçka", prane Komunes Kashar, Yrshek se bashku me Shoqerine "Klar" shpk, pajisur me NIPT K81309049N, me seli ne Rr "Durrës-itish Uzina Tirana" kane rënë dakord qe Shoqeria "Ladjus" shpk do te jete pjese e shoqerise "Klar" shpk, duke u perthithur nga "Klar" shpk me ane te procedures se bashkimit me perthithje.

2- Shoqeria "Klar" shpk zoteron 100 % te kuotave te shoqerise "Ladjus" shpk. Shkelqim Beshiri zoteron 100 % te kuotave te shoqerise "Klar" shpk.

3- Ortakut te vetem te shoqerise "Ladjus" shpk, i cili eshte subjekti "Klar" shpk, i lind e drejta e perfitimit te fitimit qe nga dita e miratimit te akt marrveshjes ndermjet dy shoqerive dhe kontabilizimit te veprimeve financiare ne shoqerine perthithese.

4- Meqenese shoqeria e perthithur zoterohet 100% nga shoqeria perthithese "Klar" shpk, atehere nuk rezulton ndonje problem i mundshem ligjor lidhur me te drejtat e zoteruesit te kuotave, si rrjedhoje e faktit te pronesisë 100% nga "Klar" shpk



5- Per faktin se, Shoqeria e perthithur "Ladjus" shpk ka te njejtin administrator si shoqeria perthithese- "Klar" shpk, Administratori do te kete te gjitha te drejtat qe Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" I Ndryshuar i njeh , me perjashtim te kompetences se perfaqesimit dhe kryerjes se veprimeve te ndryshme financiare prane te gjitha bankave te nivelit te dyte, kompetence te cilen do ta kete ortakut i vetem i shoqerise "Klar" shpk, z. Shkelqim Beshiri

6- Ortaket e vetem te dy shoqerive qe kane marre pjese ne proceduren e bashkimit me perthithje, kane rene dakord qe me dt 17.01.2015 do te nenshkruanin akt marrveshjen e bashkimit me perthithje, duke perfunduar brenda dates 17.01.2015 te gjitha procedurat ligjore dhe tatimore te domosdoshme per konkludimin e kesaj faze.

7- Dokumenta ligjore dhe pjese integrale e kesaj akt- marreveshjeje do te jene:


- Vendimi I asamblese se ortakut te vetem te "Ladjus" shpk per perfundim procedure bashkim me perthithje
- Vendimi I asamblese se ortakut te vetem te "Klar" shpk per perfundim procedure bashkim me perthithje
- Raporti ekspertit kontabele per procedure bashkim me perthithje.
- Bilanc "Ladjus" shpk- viti ushtrimor 2014.
- Miratim i pasqyrave financiare te "Ladjus" shpk.
- Bilanc "Klar" shpk- viti ushtrimor 2014.
- Miratim i pasqyrave financiare te "Klar" shpk.
- Pasqyrat financiare te bashkimit me perthithje te dy shoqerive
- Projekt Marrveshja e dt 16.01.2014.

8- Kjo akt marreveshje do te jete e detyrueshme per palet, ditën qe do te miratohet nga administratoret e dy subjekteve dhe regjistrimit te saj ne QKR.

PALET:

**"LADJUS" SHPK
ADMINISTRATOR
GENTJAN SALI**

Gentjan Sali

**"KLAR" SHPK
ADMINISTRATOR
GENTJAN SALI**

Gentjan Sali